



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA E KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA E KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	5
Nr. i faqeve Stranica No. pages	2
Nr. Pft. Arsj. Pft. Pft. No.	1533
Datë: Datum	03.07.2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datë: 03.07.2024
Nr. 5-1533

Komisioni për licencimin e BPrAL / kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 dhe në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 1533 të datës 21.05.2024 të parashtruar nga BPrAL-kolegji “Pjetër Budi” dhe mori :

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - kolegji “Pjetër Budi”, me seli në Prishtinë.
2. Licenca zgjat tri (3) vite – nga data 1 tetor 2024 deri me 30 shtator 2027, do të thotë për aq kohë sa institucioni në fjalë ka akreditim të programeve sipas vendimit me ref.877/ 24 të datës 10.05.2024 nga Agjencioni për Akreditim i Kosovës .
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 1533 të datës 21.05.2024 të parashtruar nga kolegji “Pjetër Budi”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim. Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë zgjat tri vite akademike, bazuar në vendimin e Agjencionit të Kosovës për Akreditim, do të thotë licencohet për periudhën kohore nga data 1 tetor 2024 deri me 30 shtator 2027.

Komisioni për Licencim i MASHTI duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA;
7. Arkivit.



Kryetar i Komisionit

Burim Gashi